REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 137/17
Data/Datum 13.06.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr. 137/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Goran Milenković - Kryetar z. Tefik Sylejmani- Referues, z. Nuhi Paçarizi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Eco-Higjiena"sh. p. k-Gjilan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Shërbimet e pastrimit të rrugëve, trotuareve dhe mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve, lumit dhe parqeve në Viti", me numër të prokurimit 657/17/1097/221. iniciuar nga AK-/Komuna Viti/ më datën 05.06.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet** , pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Eco-Higjiena sh. p. k" - Gjilan lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbimet e pastrimit të rrugëve, trotuareve dhe mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve, lumit dhe parqeve në Viti", me numër të prok 657/17/1097/221. iniciuar nga Autoriteti Kontraktues / Komuna Viti /.

II. **Vërtetohet,** njoftimi për dhënie të kontratës i AK-/Komuna Viti/, lidhur me aktivitetin të prokurimit "Shërbimet e pastrimit të rrugëve, trotuareve dhe mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve, lumit dhe parqeve në Viti", me numër të prok 657/17/1097/221.

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit .

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Eco-Higjienash. p. k" - Gjilan, aprovohet pjesërisht si e bazuar i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:10.02.2017

Hapja e ofertave është bërë me dt:06.04.2017, ku kanë marr pjesë dy operator ekonomik.

Njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me ketë aktivitetit të prokurimit është bërë me dt:24.04.2017, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "Qendra Kopshtare"-sh. p. k Kamenicë.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik "Eco - Higjiena"sh. p. k-Gjilan me dt: 28.04.2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 02.05.2017 autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik, "Eco-Higjiena"sh. p. k-Gjilan

Operatori ekonomik ankues "Eco-Higjiena sh. p. k" - Gjilan, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 11 maj 2017 me nr. 137/17 kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbimet e pastrimit të rrugëve, trotuareve dhe mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve, lumit dhe parqeve në Viti", me numër të prok 657/17/1097/221, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues "Komuna Viti" duke pretenduar se autoriteti kontraktues, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, ka bërë shkelje të këtyre dispozitave të LPP-së.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet 65-71 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.
- Po ashtu Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim edhe me nenin 54 të Ligjit për Prokurimin Publik

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 19.05.2017 ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 29.05.2017 bazuar në sqarimet e cekura në raport konstaton se Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vitisë, për aktivitetin e prokurimit: "Shërbimet e pastrimit te rrugëve, trotuareve dhe mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve, lumit dhe parqeve në Viti", me nr. të Prokurimit: 657/17/1097/221, nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së. Prandaj eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që të anuloj vendimin e AK-së, njoftimin për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në RIVLERESIM. ndërsa pretendimet ankimore të OE Eko-Higjiena", të **Aprovohen** si pjesërisht te bazuara.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datë: 01.06.2017, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet pjesërisht me raportin e ekspertit shqyrtues

Operatori ekonomik ankues me datë: 31.05.2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 05. 06. 2017, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, përfaqësuesi i OE ankues, eksperti i OSHP-së, Vëzhgues nga D Plus, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues "Eco Higjiena" z. Osmani ka deklaruar:Ne siç e ceku parafolësi, ne kundër këtij aktiviteti kemi ushtruar ankesë në OSHP, sepse ne kemi konsideruar që AK ka vepruar në kundërshtim me ligjin për prokurim publik, kemi konsideruar se AK nuk ka respektuar dispozitat që i kemi referuar në ankesë.

Ne kemi pranuar po ashtu edhe mendimin e ekspertit shqyrtues z. Fazliu, me të cilin raport edhe jemi pajtuar. Andaj lusim edhe njëherë panelin shqyrtues të OSHP-së që të veproj konform ankesës tonë dh konform rekomandimeve të ekspertit shqyrtues z. Fazliu.
Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-KK Viti z. Abazi ka deklaruar: KK Viti ka dorëzuar një përgjigje në mendimin e ekspertit me të cilën nuk pajtohet rreth kontinuitetit të firmës Qendra Kopshtare pasi që e njëjta vetëm ka ndërruar statusin prej NTSH në SHPK. Për këtë ne konsiderojmë se është kontinuitet i firmës së vjetër dhe si të tillë e kemi marr parasysh. Konsiderojmë se pretendimi ankimor i OE ankues nuk qëndron pasi që ne i jemi drejtuar ARBK-së me shkresë në të cilën kemi marr përgjigje se të njëjtit biznes i lejohet vazhdimësia e biznesit të mëparshëm.
Pretendimi i dytë se nuk i kemi njoftuar rreth rezultateve të tenderit, ne kemi dëshmi se përmes E-Prokurimit kemi deponuar njoftimin për tenderues të pasuksesshëm, dhe problemi ka qëndruar se OE nuk ka arritur-ditur të shkarkoj atë njoftim. Andaj KK Viti kërkon që mendimi i ekspertit të mos merret parasysh dhe të vërtetohet vendimi i AK-së që lënda të procedohet në mënyrë të rregullt duke refuzuar ankesën e OE ankues.
Kryetari i panelit konstatoi se në mungesë të ekspertit shqyrtues u lexua raporti i ekspertizës me konstatimet dhe rekomandimet e ekspertit.
Anëtari i panelit z. Sylejmani pyeti përfaqësuesin e AK se sa kontrata janë ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë. Në përgjigje z. Abazi deklaroj: OE i rekomanduar ka ofruar dy kontrata me referenca, njëra e përfunduar dhe tjetra kontratë tri vjeçare.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues z.Osmani deklaroj: Lidhur me pretendimin e AK-së të cilin dorëzoj një kopje – dëshmi se kinse njëjta është lëshuar nga Agjencioni për biznese, për mendimin tonë e njëjta do duhej të jetë e nënshkruar nga zyrtari i kësaj qendre dhe po ashtu të jetë në origjinal.Sipas ligjit për çështje tregtare 02/L-123 i ndryshuar dh plotësuar, nëse një biznes transformohet në një biznes tjetër nuk mund të ekzistojnë përsëri dy biznese të ndryshme.
Ashtu si kemi pretenduar ne si ankues edhe eksperti ka thënë se nuk ka të bëjë me transformim apo shndërrim, por që shumë qartë OE fitues është themeluar për herë të parë më muajin Janar 2016. I propozojmë panelit që të aprovohet ankesa e jonë dhe të kthehet lënda në Rivlerësim.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi AK-ës z. Abazi deklaroj: I propozojmë panelit shqyrtues të hedhe poshtë si të pabazuar ankesën e OE ankues pasi nuk është ofruar asnjë argument rreth pretendimit ankimor. ARBK ka lëshuar një informatë biznesi, dhe është praktike e tyre si të lëshojnë dokumentet, është kopje me vulë por nëse ka nevojë për origjinal mund ta sjellim. Ky biznes është në kontinuitet të biznesit të vjetër, pasi ka dy numra fiskal dhe dy numra biznesi që nënkupton vazhdimësi të biznesit. Informata e ARBK thotë Qendra Kopshtare SHPK është vazhdimësi e Qendra Kopshtare NTSH.

Në fjalën përfundimtare eksperti shqyrtuese deklaroj; qëndroj në tërësi pranë raportit të ekspertizës, si dhe pranë konstatimeve dhe rekomandimeve të dhëna në raportin e datës 29.05.2017

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit te palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë "Qendra Kopshtare" nuk është kompani e re por kjo kompani e ka ndryshuar vetëm statusin e saj duke kaluar prej Ntsh në Shpk. Pra kjo kompani është vazhdimësi e kompanisë së mëparshme me të njëjtin emër, prandaj pretendimet e OE ankues se ky operator ekonomik nuk e plotëson kërkesën në lidhje me listën e kontratave dhe referencave për shërbime të ngjashme janë të pabazuara sepse kontratat dhe referencat e kompanisë Qendra Kopshtare si NTSH konsiderohen valide dhe janë të vlefshme për këtë kompani ofertuese me emrin Qendra Kopshtare SHPK.

Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesën në lidhje me numrin e punëtorëve dhe se OE i rekomanduar për kontratë sipas RBK-së i ka të punësuar vetëm tre punëtorë, paneli shqyrtues konstaton se OE i rekomanduar për kontratë i ka ofruar listën e punëtorëve prej 20 punëtorëve duke ja bashkangjitur parakontratat,CV dhe zotimin që do ti angazhojë në këtë projekt këta punëtorë. Pra kjo kërkesë është përmbushur ashtu siç është kërkuar në FDT. Këtë e ka sqaruar edhe eksperti shqyrtues në raportin e tij. Gjithashtu është i paqëndrueshëm edhe pretendimi i OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka përmbushur vlerën e qarkullimit bankar në vlerë prej 100,000.00 € për tri vitet e fundit, pasi që OE i rekomanduar për kontratë ashtu siç e ka cekur edhe eksperti shqyrtues ka ofruar dëshmi që vetëm për vitin 2016 qarkullimin e ka në vlerë prej 280,000.00 €.
Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar tender të pazbatueshëm sipas nenit 61 të LPP-së, paneli shqyrtues konstaton se OE ankues nuk ka ofruar asnjë pretendim konkret në lidhje me këtë çështje dhe nuk ka asnjë pretendim për ndonjë pozicion që nuk mund të realizohet kontrata nga OE i rekomanduar për kontratë, prandaj ky pretendim është abstrakt dhe i pabazuar.
Paneli shqyrtues vjen në përfundim se autoriteti kontraktues e ka respektuar nenin 59 të LPP-së me rastin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Njëkohësisht është respektuar edhe nenin 60 i LPP-së, respektivisht kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Komuna e Vitis "

1x1 OE "Eco-Higjiena"sh. p. k-Gjilan

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.